



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

- Njoftim për mediumet -

Shkup, 27.04.2023

Shpërndarja e fondeve buxhetore për partitë – pa kritere të qarta!

Është konstatuar ekzistenca e kritereve jo objektive dhe qartësisht të matshme për shpërndarjen e fondeve publike për reklamat politike të paguara dhe për shpërndarjen e fondeve shtesë për rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale

Enti Shtetëror i Revizionit realizoi revizionin e përputhshmërisë me temë: „Fondet e paguara nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve lokale 2021” me qëllim që të fitohet bindje e arsyeshme nëse fondet e paguara nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve për kryerjen e veprimeve zgjedhore për zbatimin e zgjedhjeve lokale 2021, janë në pajtim me rregullativën ligjore dhe aktet e brendshme?

Me revizionin e kryer në KSHZ janë konstatuar gjendjet që kanë të bëjnë me:

- **nuk është zgjedhur** Sekretari i Përgjithshëm, në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Kodit Zgjedhor, personi i cili siguron udhëheqje efektive dhe efikase të shërbimit profesional, me të gjithë nëpunësit administrativ, unifikimin e punës së shërbimit profesional dhe mbështetjen e punës së kryetarit dhe të KSHZ-së;
- KSHZ-ja **nuk posedon dhe nuk disponon** me hapësirë të saj të magazinës, për ruajtjen e pajisjeve të prokuruar teknike (4000 aparate biometrike për identifikimin e votuesve) të cilat përkohësisht janë vendosur në SHTËPINË e ARM-së në Shkup, **hapësirë e cila është e pamjaftueshme, e përshtatshme dhe adekuate, si dhe nuk ofron siguri dhe mbrojtje** për vendosjen e pajisjeve dhe aparateve të prokuruar;
- **nuk është plotësuar vendi i punës** referent i pavarur **ekonom të magazinës**, i cili duhet të udhëheq me magazinën e KSHZ-së, **ta ruaj materialin zgjedhor, ta mirëmban** inventarin e pajisjeve dhe materialit të harxhuar, gjë që krijon rrezikun e trajtimit jo adekuat dhe ruajtjen e stoqeve të materialeve zgjedhore, që mund

të sjellin dëmtimin e përhershëm të tyre dhe pamundësinë e përdorimit të tyre në proceset e ardhshme zgjedhore.

Gjithashtu, janë konstatuar edhe disa **mospërputhje dhe lëshime** në zbatimin e **procedurës së prokurimit publik** të shërbimeve - prodhim dhe shtypje të materialit zgjedhor konfidencial dhe listën zgjedhore për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave të komunave dhe këshillit të Qytetit të Shkupit dhe për kryetarët të komunave dhe kryetar të Qytetit të Shkupit, të cilat i referohen prokurimit të mallrave dhe shërbimeve për nevojat e zbatimit të zgjedhjeve lokale 2021, të cilat shpjen në **ndikim të mundshëm** në konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe çmimin që mund të arrihet dhe atë:

- **është lidhur marrëveshje për prokurim publik** të shërbimit - prodhim dhe shtypje të materialit zgjedhor konfidencial dhe listës zgjedhore për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave të komunave dhe këshillit të Qytetit të Shkupit dhe për kryetarët të komunave dhe kryetar të Qytetit të Shkupit, **në shumë totale prej 53 milion denarë**. Lënda e dokumentacionit të tenderit është e **pandashme, e përbërë nga më shumë zëra**, gjatë të cilës një pjesë nga zërat janë theksuar si **konfidencial**, dhe i njëjti sipas Udhëzimit për përcaktimin e llojeve të materialit zgjedhor të miratuar nga KSHZ-ja, **ato konsiderohen si material zgjedhor jokonfidencial**;
- organi kontraktues në formularin e ofertës **nuk i ka specifikuar** kërkesat për përcaktimin e një **çmimi individual për secilin artikull veçmas sipas sasisë së kërkuar**, gjegjësisht operatori ekonomik ofron çmimin total për të gjithë prokurimin, i cili **nuk është në pajtim** me nenin 81 paragrafi 1 të Ligjit për prokurim publik;
- vlera e shërbimit **shprehet** si vlera totale e kontratës, gjegjësisht në faturën dhe specifikacionin e shërbimit nuk shprehet çmimi individual i sasisë sipas secilit artikull veçmas, gjë që nuk është në pajtim me nenin 82 paragrafi 1 të Ligjit për prokurim publik dhe
- gjatë zgjedhjeve, është **lidhur aneks** i kontratës për prokurim të një sasive shtesë të ribotimit të fletëvotimeve për anëtarët e këshillit të Komunës së Butelit për shkak të anashkalimit të bërë në simbolin e një partie politike, dhe paravanët e votimit në **vlerë totale prej 1 milion denarë** me çmime të dhëna për njësi, të cilat më parë nuk janë theksuar fare në kontratën themelore.

Me ndryshimet dhe plotësimet e **Kodit Zgjedhor në shkurt të 2020** është paraparë votim me zbatimin e **pajisjes teknike për identifikimin e votuesit**. Procedura për prokurim publik të **sistemit integruar për identifikimin biometrik** të votuesit me shumën totale **prej 679 milion denarë pa TVSH**, u pasua me ankesa dhe padi në lidhje me dokumentacionin e tenderit dhe specifikimin teknik të cilat u refuzuan si të pa baza nga Komisioni Shtetëror i ankesave për prokurimet publike dhe Gjykata Administrative.

Me revizionin janë konstatuar gjendje që **krijojnë rrezik** pajisjet e parapara për identifikimin biometrik të votuesve në KSHZ të mos dorëzohen në pajtim me dokumentacionin teknik dhe të tenderit, gjegjësisht:

- nga katër ofertat **e dorëzuara** të operatorëve ekonomik, vetëm një i ka plotësuar kushtet plotësisht të dokumentacionit teknik dhe të tenderit, ndërsa me përzgjedhjen e të njëjtit si ofertues më i favorshëm, dy anëtarë të Komisionit për zbatimin e prokurimit publik **nuk janë pajtuar**,
- procesverbali i **pranimit cilësor dhe sasior** të 200 kompleteve të aparateve biometrike, procesverbali i testit të **pranimit të sistemit për identifikimin biometrik të votuesit**, në të cilën është theksuar se kanë qenë të pranishëm dhjetë persona nga KSHZ-ja dhe nëntë nga bartësi i prokurimit, por të njëjtit nuk janë nënshkruar në të dhe procesverbali **për dinamikën e marrjes së aparateve biometrike**, janë të nënshkruara vetëm nga kryetari i KSHZ-së, dhe jo edhe nga personi i autorizuar për kryerjen e pranimit cilësor dhe sasior;
- janë dorëzuar **njoftimet nga pesë persona** të theksuar si të pranishëm në Procesverbalin për testin e pranimit deri te Kryetari dhe anëtarët e KSHZ-së, në të cilat theksojnë se në takimin që janë ftuar gojarisht, është shfaqur vetëm **prezantimi power point** në të cilën u prezantuan në mënyrë të përmbledhur aktivitetet e kryera deri në atë moment dhe se **nuk është konstatuar funksionimi dhe vënia në punë e sistemit** dhe e njëjta **nuk përbënte test për ta pranuar sistemin** si dhe **nuk është kryer pranimi teknik cilësor i sistemit**;
- është përgatitur **Raport për aktivitete e zbatuara për prezantimin dhe përdorimin e AIBV** para zbatimit të Zgjedhjeve Lokale 2021, por prej dy anëtarëve të trupi koordinues për TIK dhe sigurisë në KSHZ, është dorëzuar njoftim me rekomandime **për të bërë një pranim cilësor teknik të aparateve** me të cilën do të konfirmohet përputhshmëria e aparateve dhe sistemit në tërësi me kërkesat minimale teknike në prokurim;
- në shtojcë të **Procesverbalit për kryerjen e pranimit sasior dhe cilësor nuk ka asnjë dokumentacion shtesë** që do të konfirmonte pranimin cilësor të sistemit të integruar për identifikim biometrik të votuesit në tërësi, që nuk është **në përputhje** me pikën 7.8 Pranimi cilësor dhe sasior i dokumentacionit të tenderit në të cilën është theksuar se gjatë pranim-dorëzimit përcaktohet cilësia dhe sasia e mallit të dorëzuar dhe **nuk është në përputhje** me nenin 23 të kontratës së lidhur në të cilën është paraparë se pranimi cilësor dhe sasior përcaktohet nga personi i autorizuar i palëve të kontraktuar gjatë pranim-dorëzimit të mallrave.

Me miratimin e Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Kodit Zgjedhor nga 16.09.2021 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 215/22) **janë kryer ndryshime te neni 76-d paragrafi 5** me të cilën është përcaktuar shuma e fondeve totale që do të sigurohet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për reklamim politik të paguar dhe shpërndarjen e tyre sipas pjesëmarrësve individual në fushatën zgjedhore.

Në bazë të kriterëve të cilat do të zbatohen gjatë shpërndarjes së këtyre fondeve sipas pjesëmarrësve individual në fushatën zgjedhore, është përcaktuar shpërndarja e mjeteve totale sipas marrëveshjes të mëparshme me shkrim në mënyrën si vijon:


- **më së shumti 45%** të fondeve mund ti shfrytëzohen nga **dy partitë politike më të mëdha nga pozita**, të cilët kanë fituar më shumti vota në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvend;
- **më së shumti 45%** të fondeve mund të shfrytëzohen nga **dy partitë politike më të mëdha nga opozita**, të cilët kanë fituar më shumti vota në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvend;
- **më së shumti 7%** të fondeve mund të shfrytëzohen nga **partitë politike** në Kuvend të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë **nuk fituan deputet të mjaftueshëm për të formuar grup deputetësh** dhe
- **më së shumti 3%** të fondeve mund të shfrytëzohen nga partitë politik të cilët nuk përfaqësohen në Kuvend ose kandidat.

Me analizën e kryer të zbatimit të dispozitave të lartpërmendura, revizioni i ka konstatuar këto gjendje:

- shpërndarja e fondeve totale **në shumë prej rreth 323 milion denarë** të paguara për reklama politike të paguara sipas parimit 45%, 45%, 7% dhe 3%, **nuk siguron kritere objektive dhe të arsyeshme** për shpërndarjen e fondeve publike, **duke u dhënë avantazh të konsiderueshëm** partive më të mëdha parlamentare, duke i kufizuar mundësitë e partive të tjera dhe kandidatëve të pavarur për të prezantuar programet e tyre tek radiodifuzerët, mediat elektronike dhe të shkruara dhe
- me **mënyrën e përcaktuar për caktimin e 1 (një) euro shtesë në kundërvlerë në denarë pa llogaritur TVSH-në** për votues të regjistruar në territorin e komunës ku zhvillohet **rrethi i dytë i votimit për zgjedhjet lokale**, mungon përcaktimi i kritereve të qarta nëse fontet shtesë për rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale do të sigurohen nga votuesit total të regjistruar në territorin e komunës në të cilën zhvillohet rrethi i dytë i votimeve, pavarësisht nga ajo nëse pjesëmarrësit në procesin zgjedhor paraqiten me kandidat të tyre në komunat ku zhvillohet rrethi i dytë i votimit.

Në grafikun e mëposhtëm është shfaqur shpërndarja e fondeve të paguara për reklamimin politik të paguar:

REKLAMIMI POLITIK ME PAGESË për pjesëmarrës



Shpërndarja e fondeve shtesë të paguara për RRETHIN E DYTË të votimit

37.593 mijë denarë

fonde të paguara për dy partitë politike me të mëdhenj të cilët fituan më së shumti vota në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvend të RMV-së

26.115 mijë denarë

fonde të paguara për dy partitë politike me të mëdhenj të cilët fituan më së shumti vota në zgjedhjet e fundit për deputetë në Kuvend të RMV-së

878 mijë denarë

fonde të paguara për partitë politike në Kuvend të cilët në zgjedhjet e fundit për deputetë nuk fituan deputet të mjaftueshëm për të formuar grup deputetësh

850 mijë denarë

fonde të paguara për partitë politike të cilët nuk përfaqësohen në Kuvend të RMV-së ose kandidat



Për rrethin e dytë të votimit zbatohen mënyra të ndryshme të shpërndarjes dhe pagesës së fondeve, gjegjësisht të një pjesë e partive politike janë paguar fonde në pajtim me numrin e votuesit total të regjistruar në territorin e komunës në të cilën zhvillohet rrethi i dytë i votimeve, ndërsa të një pjesë shpërndarja dhe pagesa është kryer në pajtim me numrin e votuesit total të regjistruar në territorin e komunës në të cilën zhvillohet rrethi i dytë i votimeve dhe ku pjesëmarrësi në procesin zgjedhorë paraqitet me kandidatin e vet.

Në pjesën e **Theksimit të çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë** është theksuar gjendja e cila i referohet se edhe përkundër asaj që **dy pjesëmarrës në fushatën zgjedhore** të bartësit e qarkullimit pagesor **nuk kanë hapur llogari transaksioni me tregues "për fushatën zgjedhore"**, komisioni kompetent zgjedhor ka miratuar **aktvendim** me të cilin **konfirmohen listat** e kandidatëve për zgjedhje të kryetarëve të komunave, gjegjësisht zgjedhjen e anëtarëve të këshillit dhe mundëson i njëjti të merr pjesë në procesin zgjedhor.

Në pjesën e **Çështjeve të mbetura**, revizioni e konsideron të nevojshme **sygjerimin për nevojën e:**

- **rregullimi i nenit 76-d të kodit Zgjedhorë** duke përcaktuar kriteret e matshme në pjesën e fondeve të shpërndara dhe të siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut të dedikuara për reklamimin politik të paguar;
- **përcaktimi i dispozitave** që do të rregullojnë nëse një koalicion apo parti politike mund të mbështesë një kandidat të pavarur – grup të zgjedhësve dhe të përdorë fondet e ndara për reklama politike të paguara për kandidatin e pavarur – grup të zgjedhësve, nëse mundet në çfarë kushtesh dhe në çfarë mënyre dhe nëse me këtë mbështetje ka të drejtë të përdorë fondet që i takojnë si kandidat i pavarur;
- **përcaktimi i organit kompetent për monitorimin dhe raportimin e përfaqësimit** mediatik zgjedhor të mediave elektronike (portalet e internetit);

- **të plotësohet neni 76-d paragrafi 11 të Kodit Zgjedhorë** dhe të parashihet vendosja e sistemit interoperabil për shkëmbimin dhe kontroll të të dhënave për aktivitet të banderolëve në të cilat do të kyçen të gjithë palët e interesuar;
- **të rregullohen kushtet dhe kriteret** të cilat janë të nevojshme për ti plotësuar mediat elektronike që të kenë mundësi të aplikojnë për reklama politike në KSHZ;
- **të përcaktohen kriteret të qarta dhe të sakta** për shpërndarjen e fondeve buxhetore të dedikuara për reklamim politik të paguar në mediat elektronike (portale interneti) dhe
- nevoja për aktvendim ligjorë për shfrytëzimin e fondeve financiare nga ndarja MF-Funksione të shtetit si plan financiar (e drejta për shpenzim) me të cilën mundësohet miratimi dhe pagesa e fondeve për dedikimet të cilat mund të planifikohen në fazën e përgatitjes së Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjegjësisht në kuadër të buxhetit të KSHZ-së për plotësimin e detyrimeve ligjore të lidhura me procesin zgjedhor.

Press kontakti:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72 228 203 albiona.mustafa@dzt.gov.mk

Mijaçe Durgutov +389 70 358 486 mijalce.durgutov@dzt.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517 martin.duvnjak@dzt.gov.mk